



Republika e Kosovës-
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government



Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve
Nacionalni Autoritet za Kualifikacije
National Qualification Authority

Numër: 01-127
Datë: 27.02.2017

Në mbështetje të neneve 4, dhe 23, të Ligjit nr.03/L-189 për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës, të neneve 6 dhe 16 të Ligjit nr. 03/L-060 për Kualifikimet Kombëtare dhe Udhëzimit Administrativ (MASHT) nr. 35/2014 - Kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime në Kosovë, Këshilli Drejtues i Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve në mbledhjen e mbajtur me datë 16.02.2017 nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Akreditohet dhe validohet **Qendra e Bukurisë "American Beauty"** në Ferizaj dhe Gjilan, për periudhën **08.02.2017** deri **08.02.2020** për të ofruar kualifikime të validuara në KKK:
 - 1.1. **Grimer; Niveli III sipas KKK,**
2. Akreditimi dhe validimi i institucionit/ofruesit është aprovuar me kushtet si në vijim:
 - 2.1 Trajnimi dhe certifikimi i asistenteve si në pjesën e metodologjisë dhe në pjesën praktike
 - 2.2 Mundësimi i funksionimit të sistemit të ngrohjes
 - 2.3 Detyrimisht data e fillimit të procesit mësimor për të gjithë kandidatët e regjistruar për çdo grup të ri të formuar të jetë unike.
 - 2.4 Integrimi i nje specialisti të jashtëm nga biznesi në komisionin e vlerësimit në testin përfundimtar teoriko-praktik është i domosdoshëm.
 - 2.5 Krijimi i faciliteteve të domosdoshme (ashensor) për kandidatët me aftësi të kufizuara.
 - 2.6 Të bëjnë orë mesimore për mënyrën e përdorimit të kutisë së ndihmës së shpejtë.
 - 2.7 Trajnerja e praktikës mesimore e grimit të paiset me regjistër ku të pasqyrojë datat-temat-vijushmerinë –vlerësimin e kandidatëve.

2.8 Të vendoset kodi i miresjelljes në ambiente {Ferizaj}

2.9 Të hartojë një model të strukturuar të vlerësimit të përfundimtar të kandidatëve {proces-verbal} i cila të shërbeje si bazë dokumentimi për vlerësimin dhe nënshkrimin e anëtarëve të panelit vlerësues.

3. Kushtet e parashtruara për aprovim dhe akreditim duhet të përmbushen deri më datën **31.05.2017**, në rastin kur institucioni/ofruesi nuk i përmbushë këto kritere, AKK ka të drejtë tërheqjen e aprovimit dhe akreditimit.

Arsyetim

Në bazë të kërkesës së institucionit/ofruesit dhe rekomandimet të dala nga Raporti i Vlerësimit të Panelit të ekspertëve mbi Validimin e kualifikimit, Raporti i Vlerësimit të Panelit të ekspertëve mbi Akreditimin e Institucionit i cili ofron dhe/ose vlereson dhe lëshon kualifikime të aprovuara të cilat rekomandime janë të mbështetura në dëshmi dhe dokumente të ofruara: Aplikacioni për Validim të Kualifikimit/Modulit; Aplikacioni për Akreditim si Institucionit ofrues dhe/ose Vlerësues dhe Lëshues të Kualifikimit; Raporti i Vetë-vlerësimit; Vizita në institucionin/ofruesin aplikues dhe dokumente tjera shtesë, u vendos si në dispozitivin e këtij vendimi.

Këshillë Juridike:

Pala e pakënaqur me vendimin ka drejtë ankese në organet e shkallës së dytë brenda afatit kohor prej 30 ditëve. Ankesa bëhet përmes organit të shkallës së parë.

4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

5. Vendimi u dërgohet:

- American Beauty;
- AKK.



Bedri Xhafa

Anëtari i KD së AKK-së